
KËRKESË PËR OFERTË PËR OFRUES SHËRBIM BLERJA E BILETAVE PËR MYSAFIR TË FESTIVALIT

Procedura për kuotimin e çmimeve

Numri kërkesës për ofertim:	DFO 001 /25
Data e ftesës:	15.04.2025
Data e mbylljes:	10.05.2025
Titulli i kontratës:	Shërbim blerja e biletave për mysafiret e festivalit
Autoriteti Kontraktues	DokuFest
Adresa:	DokuFest - Rr.Marin Barleti Pn.,20000 Prizren
E-mail:	procurement@dokufest.com

PËRMBLEDHJE

DokuFest ju fton të paraqisni ofertat për:

KËRKESË – Shërbim blerja e biletave për mysafirët e festivalit

Qëllimi i kësaj ftese për ofertim është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për shërbimet e kërkuara. Ftesa për ofertë është për një subjekt tregtar/agjensi udhëtimi për rezervimin dhe blerjen e biletave të udhëtimit ajror ndërkombëtar (ardhje & vajtje) për mysafirët e festivalit të cilët do të udhëtojnë për në Kosovë në datat nga 01 – 09 Gusht 2025.

Mysafirët janë nga vendet të ndryshme të botës dhe nga kompanitë kërkojmë :

- Ofrim i shërbimit dhe asistencës nga stafi përgjatë gjithë kohës, për komunikim dhe menaxhim të çështjeve që lidhen me rezervimet, procesimet, si dhe anulimet.
- Gjatë **periudhës Maj - Qershor 2025**, kërkohet që në dispozicion të jetë **një (1) staf 24/7**;
- Gjatë **periudhës Qeshor - Korrik 2025**, kërkohet që në dispozicion të jenë **dy (2) staf 24/7** (për shkak te fluksit te madh te kerkesave).

-
- Ofertuesi duhet të sigurojë ofrim të shërbimeve të kontraktuara në kohë, në përputhje me afatet e përcaktuara në kontratë.

Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë ofertat e tyre në emailin zyrtar procurement@dokufest.com deri më 10.05.2025.

Më poshtë gjeni dokumentin ku mund të bazoheni për ofertim.

KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjithë te ftuarit duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë: -

Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim

- Duhet të shënohet data e ofertës
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 30 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së (të gjitha në kopje/scan) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve.
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket cmimi për materialet, propozimet, dhe intervistat (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, Dokufest do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH- në,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze, - Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 10.05.2025 ora 00:00.

SHËNIM ME RËNDËSI:

- i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të

prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.

iii) Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 10.05.2025, ora 00:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresa: procurement@dokufest.com . Pyetjet pranohen deri më 10.05.2025.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 15 Maj 2025. Komisioni përzgjedhës
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
1. Kriteret Kualitative	
1.1. Pergaditja, pervoja, propozimet konkrete	40%
2. Kriteret Financiare	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60%
Total:	100%